

NJË JETË KUSHTUAR STUDIMIT TË PERIUDHËS OSMANE TE SHQIPTARËT



Prof. dr. Skender Rizaj
(1930- 2021)

Më 28 nëntor të vitit 2021, në Prishtinë, u dha lajmi për vdekjen e ish të burgosurit politik, pedagogut, studiuesit, Profesorit shumëvjeçar të Universitetit të Prishtinës, bashkëpunëtorit të Institutit Albanologjik, ish-kryeredaktorit të revistës “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave historike për afro një dekadë, prof. dr. Skender Rizaj.

Skender Rizaj u lind në Pejë, më 14 mars 1930. Vinte nga një familje autoritare hoxhallarësh të asaj ane, të cilët njihnin mirë gjuhët orientale, ndaj prof. S. Rizaj arriti të merrte njohuri solide për këto gjuhë. Veçmas i mori bazat nga babi i tij Esherfi, i cili ishte hoxhë me autoritet¹, për të vazhduar me specializime për osmanisht si në Sarajevë e në Stamboll. Më 1941, në Pejë, ka kryer shkollën fillore dhe më 1945 në po të njëjtin qytet e ka përfunduar semimaturën. Gjatë viteve 1946-1947 në Prizren ka përfunduar dy kurse pedagogjike-shkollën normale. Më 1956 në Shkup, e ka kryer Fakultetit Filozofik - Dega e Historisë, në Beograd më 1960 e përfundoi provimin

¹ “Prindërve të dashur e të nderuar, Eshref M. Rizaj, hafiz-hoxhë popullor (vdekur në Pejë, më 1953) dhe Habibe Rizaj (Sapunxhiu), shtëpiake (vdekur në Prishtinë, më 1968), të cilët më ngritën me vetëmohime të mëdha-Autori”-Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 5.

shtetëror për pro-fesor të gjimnazit, ndërsa më 1965, në Sarajevë i përfundon stu-dimet pasuniversitare dhe doktoraturën.

Në moshë 17-vjeçare, angazhohet në lëvizjen ilegale “Besa Kombëtare” e cila vepronte asokohe në Kosovës, ku mbante pseudonimin “Fishkëllima”. Iurvejuar nga organet e sigurisë të asaj kohe, arrestohet dhe Gjykata e Qarkut në Prizren, në nëntor të vitit 1946, si nxënës i shqiptoi dënimin me 1 vit burgim të rëndë.²

Gjatë vitit 1948 ka shërbyer si mësues në katundin Gllaviçicë të Pejës. Nga viti 1948 e deri më 1952 në Pejë ishte mësues dhe drejtor i shkollës fillore, gjatë viteve 1956-1961 profesor i gjimnazit, pastaj nga viti 1961 deri më 1963 Skender Rizen e gjejmë në Prishtinë si arkivist i Arkivit të Kosovës për t’u kthyer përsëri në Pejë si arsimtar i shkollës fillore në vitet 1963-1965. Pas përfundimit të doktoraturës, si i vetmi historian shqiptar në Kosovë me titullin doktor i shkencave, inkuadrohet në Universitetin e Prishtinës, fillimisht si asistent e pastaj docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar. Këta tituj i mori gjatë viteve të punës së tij në Universitet 1965-1987. Duke njohur cilësitë e tij prej osmanisti, Profesori, me ftesë të organeve kompetente të Turqisë, angazhohet në Stamboll gjatë viteve 1989-1990 si këshilltar kompetent - specialist (uzmanı) i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të Qeverisë Turke (Başbakanlık Arşivi).

Pas mbarimit të doktoraturës, i lidhur shpirtërisht me osmanishten, prof. S. Rizaj nuk do të ndalet së hulumtuari dokumente për periudhën osmane të shqiptarët. Krahas gjuhëve orientale, zgjeroi njohuritë edhe në gjuhën angleze, duke i dhënë mundësi që të bëjë, krahasime me dokumente historike nga të dyja anët e botës, orientit dhe oksidentit.

Zotërimi i gjuhëve të huaja ia hapi rrugën prof. S. Rizajt për hulumtime në biblioteka dhe arkiva në shumë qendra dhe institucione të ndryshme shkencore të botës. si në: Sarajevë, Ankara, Beograd, Shkup, Zagreb, Dubrovnik, Prishtinë, Tiranë, Romë etj. Më së shumti ka bërë hulumtime në Stamboll në (Başbakanlık Arşivi , në bibliotekat: Bayezid, Süleymaniye, Devlet Kütüphanesi) dhe në Londër (The Public Record Office, The British Museum, The British Library).

Vendin kryesor në veprimtarinë e tij shkencore në historiografinë shqiptare e zënë studimet që kanë të bëjnë me historinë e popullit shqiptar në periudhën e Perandorisë Osmane.

² Arkivi i Kosovës, Prishtinë (më tej: AK), Fondi, Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda Penalja, Viti 1946, nr. 20. Dënimi ju shqiptua në bazë të nenit 3/1 të ligjeve të atëherëshme në fuqi.

Ka marrë pjesë me referate dhe kumtesa në kongrese, simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare të mbajtura në ish-Jugosllavi (në Prishtinë, Beograd, Sarajevë, Sjenicë, Mostar, Shkup); në Shqipëri (në Tiranë); në Turqi (në Stamboll, Ankara, Edrene); në Greqi (Athinë); në Rumani (Bukuresht); në Gjermani (Munih); në Itali (Palermo). Këto referate dhe kumtesa janë botuar si materiale të kongreseve, të simpoziumeve, të konferencave përkatëse.

Ka botuar një mori studimesh shkencore dhe profesionale: studime monografike, tekste shkollore dhe universitare, artikuj, kontribute, fejtone, kritika, recensione etj. Punimet i ka shkruar dhe publikuar: në gjuhën shqipe, serbokroate, maqedonase, sllovene, angleze, turke, italiane, gjermane, arabe; kurse i ka botuar në: Prishtinë, Pejë, Prizren, Sarajevë, Zagreb, Shkup, Vrajë, Kralevë, Lubjanë, Sjenicë, Novi Sad, Tiranë, Stamboll, Edrene, Ankara, Athinë, Bukuresht, Palermo, New Jersi (SHBA), Munih (Gjermani), Irbid (Jordani).

Ndër kontributet më të çmueshme, veçojmë veprat të cilat po i paraqesim në rend kronologjik:

Rudarstvo Kosova i susednih krajeva od XV do XVII veka, ZNUK, Prishtina, 1968; *Historia për klasën VII të shkollës fillore*³, ETMMKSAK, Prishtinë, 1975; *Historia për klasën e VII të shkollës fillore*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1977; *Historia për klasën VI të shkollës fillore*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1978; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze*, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1978; *Tarih İlkokul VI sınıf*, Priştine, 1979; *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*⁴, Rilindja, Prishtinë, 1982; *Historia e përgjithshme Koha e Re (1453-1789)*, UK-FF, Prishtinë, 1985; *Shqiptarët dhe serbët në Kosovë*, Zëri i Rinisë, Prishtinë, 1991; *Kosova, shqiptarët dhe turqit dje, sot dhe nesër*, AISHSHA, Prishtinë, Istanbul, Tiranë, 1993; *Burime turke (osmane) mbi luftën e shqiptarëve për pavarësi dhe humbja e Ballkanit (1908-1912)*, Istanbul, 1993; *Pasqyrë e shkurtër e shtetësisë në zhvillim: të pellazgëve – ilirëve = shqiptarëve gjatë shekujve / A short of nationality in progres: /Of Pelasgians – Illyrians – Albanians throughout the centuries*, Shkencat dhe artet shqiptare/Albanian sciences and arts/ Arnaut Bilimleri ve Sanatları, 1-4/1992, İstanbul 1993; *Shqiptarët popull i ndarë*⁵, libri i parë, Pejë, 1996 *Shqiptarët popull i ndarë*, libri i dytë⁶, Pejë, 1996; *Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e*

³ Bashkautor me Muhamet Pirraku.

⁴ Ky libër është botuar edhe në Tiranë. *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Nëntori, Tiranë, 1987.

⁵ Bashkautor me Giuseppe Catapano dhe Nerimin Vlora-Falaschi.

⁶ Bashkautor me Giuseppe Catapano dhe Nerimin Vlora-Falaschi.

copëtimit të Ballkanit (1877-1885), Libri I, Rilindja, Prishtinë, 1996; *Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit (1877-1885)*, Libri II, Rilindja, Prishtinë, 1996; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1877-1885)*, Prizren, 1998; *E drejta historike e shqiptarëve për vetëvendosje*, Prishtinë, 2005; *The short story of genocide on albanians and bosniacs (1689-1995-1999)*, Prishtinë, 2006; *Falsifikimet e historiografisë serbe*, Prishtinë, 2006; *Vilajetet Shqiptare – Vilajeti i Kosovës (1864-1912) / Albanian Vilayets - Vilayet of Kosova (1864-1912) (I,II)*, Prishtinë, 2008; *Gazeta turke dhe amerikane për gjenocidin serb ndaj shqiptarëve (1999) - Disa përjetimetime të mia - (1,2) / The Turkish & American Newspapers about Serbian Genocide on Albanians (1999) - Some my experiences - (1,2) (Kronika - The Cronicle)*, Prishtinë, 2009.

Duhet thënë, se disa nga veprat e Profesorit morën vlerësimet maksimale nga ekspertët e historisë, si në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Stamboll, Londër etj. Opusi shkrimor i Profesor Rizajt mbetet pikë reference edhe sot e kësaj dite nga studiuesit tanë dhe të huaj.

Ai, për shumë çështje të historisë shqiptare dhe ballkanike, sikurse ishin: *kishat serbe në Kosovë, e ashtuquajtura dyndje e madhe serbe nga Kosova, islamizimi te shqiptarët, Lidhja Shqiptare e Prizrenit* etj. nuk ndoqi linjën tradicionale të interpretimit të historisë, por vazhdoi me trajtimin e këtyre çështjeve duke e pasur gjithmonë si udhërrëfyes të vërtetën shkencore mbështetur vetëm në argumente të mirëfillta. Për disa nga problematikat në historinë shqiptare polemizoi me studiues të ndryshëm duke përdorur gjithnjë gjuhën e argumentit.

Punë të vyer shkrimore e profesionale Profesori dha edhe në Institutin Albanologjik. Nga rithemelimi i këtij Institucioni më 1967, Profesori ishte nga bashkëpunëtorët më të vyer. Ai nga vitit 1976 e deri në vitin 1984, për afro një dekadë, ishte kryeredaktor i revistës “Gjurmime albanologjike” - seria e shkencave historike. Disa nga punimet e tij, të botuar në revistën “Gjurmime albanologjike” – seria e shkencave historike dhe në disa botime të tjera të këtij institucioni janë këto:

“Transferimet, deportimet dhe dyndjet e shqiptarëve në kohën e Skenderbeut”, *Simpoziumi për Skenderbeun*, (9-12 maj 1968), IAP, Prishtinë, 1968, f. 145-153;

“Lufta fraksioniste në mes të shoqërive letrare “Bashkimit” dhe “Agimit”, *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, FF, Prishtinë, 1969, f. 118-128;

“Drejt paqes së Shën Stefanit (1878) në dritën e burimeve turko-osmane dhe angleze”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. VI- IAP, Prishtinë, 1976, f. 49-70;

“Çështja shqiptare në marrëveshjet e Fuqive të Mëdha të Evropës (1878-1881)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. VII, IAP, Prishtinë, 1977, f. 151-188;

“Synimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)”, *Gjurmime albanologjike - SSHH*, nr. VIII, IAP, Prishtinë 1978, f. 151-184;

“Disa të dhëna antroponomike e toponomike mbi popullsinë e Kosovës në shekujt XIV-XV në dritën e burimeve osmane”, *Onomastika e Kosovës*, (Simpozium i mbajtur 25-27 shkurt 1977), IAP, Prishtinë, 1979, f. 155-161;

“Rezistenca e turmave shqiptare kundër qeverisë osmane (1881-1885)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. X, IAP, Prishtinë, 1980, f. 83-101;

“Jeta dhe veprimtaria politiko - patriotike e Abdyl Frashërit deri në Kongresin e Berlinit (1878)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. XI, IAP, Prishtinë, 1981, f. 151-175;

“Mbi të ashtuquajturën dyndje e madhe serbe nga Kosova në krye me patrikun Arsenije Çarnojeviq (1690)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. XII, IAP, Prishtinë, 1982, f. 81-103;

“Prizreni deri te Tanzimati (1839)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. XIII, IAP, Prishtinë, 1983, f. 51-82;

“Anglezi sir Edwin Pears mbi shqiptarët”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. 14, IAP, Prishtinë, 1984, f. 193-223;

“Disa të dhëna për Pejën gjatë shekujve XV, XVI, dhe XVII”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. 15, IAP, Prishtinë, 1985, f. 119-143;

“Janjeva gjatë shekujve XV dhe XVI”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. 16, IAP, Prishtinë, 1986, f. 11-102;

“Disa të dhëna për Pejën gjatë shekujve XVIII, XIX dhe XX(1700-1912)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. 17, IAP, Prishtinë, 1987, f. 127-146;

“Prishtina gjatë shekujve XVII-XX(1912)”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. 18, IAP, Prishtinë, 1988, f. 87-109;

“Roli i Mithat Pashës në krijimin e Vilajetit të Kosovës”, *Gjurmime albanologjike- SSHH*, nr. 20, IAP, Prishtinë, 1991, f. 181-200.

Profesori ndërroi jetë më 28 nëntor 2021, në një datë të shënuar për shqiptarët, datë të cilën kishte bërë përpjekje ta ndriçonte mbi bazën e burimeve.

U varros, më 29 nëntor 2021, në Prishtinë, në prani të shumë familjarëve, miqve, ish-studentëve e dashamirëve të tij.

Pa dyshim se jeta e pedagogut, e studiuesit, e veprimtarit, e Profesorit Skender Rizaj, do të shërbejë si referencë për gjeneratat pas tij.

Nuridin AHMETI